Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar-Primljeno Me Dana 28-09-2026			
Nr. I Organit Org. Broj	Numri Broj	Shtojca Prilog	Vlera Vrednost
01-	110/05-		1018

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, shkronja d, neni 17 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/1008), kërkesa nga Ministria e Financave Nr. 928-1/2026 e datës 28.05.2026, nenit 36 shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr.013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 25.09.2026 miraton këtë:

V E N D I M

për shfuqizimin e Vendimit Nr.01-110/05-490, të datës 04.05.2026 për kthimin e mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendit i Komunës së Vitisë miraton vendimin për shfuqizimin e Vendimit Nr.01-110/05-490, të datës 04.05.2026 për kthimin e mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale.

Neni 2

Shfuqizimi i vendimit bëhet me kërkesë të Ministrisë për Financa, me Nr.928-1/2026, të datës 28.05.2026.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr.08/L284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr.08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27, dhjetor 2024), nenin 5, paragrafi 1, si dhe nenin 8, lidhur me nenin 9, paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare, në web faqe të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:
1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorive përkatëse;
3. Shërbimit të Kuvendit; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi